

INTERVISTË ME DRITON KAJTAZI

TË JEMI KRENAR E MIRËNJOHËS ME PUNËN E PRINDËRVE TANË MËRGIMTARË

Driton Kajtazi është mësimdhënës i Frengjishtës, i Projekteve dhe i Historisë Fetare dhe Biblike në Kolegjin Léon-Michaud në Yverdon-les-Bains të Zvicrës (nga viti 2003). Është bashkë-themelues dhe Drejtor i Institutit Zvicëranc të Studimeve Shqiptare (ISEAL). Është autor i Hënore e Zvicrës (Antologji e letërsisë së Zvicrës franceze, në shqip) dhe i pjesës teatrorre Guri Ura, l'étranger d'ici - Guri Ura, i huaji vendor. Është emëruar në vitin 2008 nga Qeveria e Kantonit Vaud anëtar i Dhomës kantonale konsultuese të të huajve dhe anëtar i jurisë kantonale për çmimin e integrimit Le Milieu du Monde.

albsuisse: Ju me 23 prill 2010, e keni themeluar Institutin Zvicëranc për Studime Shqiptare (ISEAL).

Driton Kajtazi: Ne më 23 prill 2010 kemi dalë publikisht me komunikatë, por ideja e krijuar të ISEAL-it ka filluar herët, që në vitin 1999. Atë kohë isha kordinator i Unionit të Studentëve Shqiptarë në Zvicër dhe në kuadër të bashkëpunimeve me Unionin e Studentëve Zvicëranc në Bern (UNES), ne po shikonim se si të kristalizojmë veprimet dhe bashkëpunimet në kushtet e pasluftës.

Fryt (s'po kuptoj) vitesh pune, statutet e fondacionit ISEAL-it janë miratuar zyrtarisht nga 11 anëtarë themelues më 8 dhjetor 2007 në Lozanë, në prani të notarit zyrtar.

Themelues të ISEAL-it janë: zonja Barbara BURRI-SHARANI - psikologe, zonja Magaly HANSELMANN - zëvendës presidentë e Konferencës Zvicërane të Delegatëve Kantonalë e Komunalë për Integrim, Prof. Dr. Doris JAKUBEC - ish-drejtoreshë e Qendrës së Kërkimeve Letrare të Zvicrës Franceze, M. Daniel ABIMI - gazetar, M. Francis COUSIN - ish-ambasador, M. Driton KAJTAZI - autor dhe mësimdhënës, Prof. Dr. Peter KNOEPFEL - Profesor titullar i katedrës së politikave publike, afatgjata e zhvillimore pranë IDHEAP-it, Dr. Régis MARION-VEYRON - mjek-psikiatër, M. Bruno MIGLIARINI - kuadër bankar, M. Victor RUFFY - gjeograf, ish-kryetar i Parlamentit Zvicëranc, Prof. Dr. Basil SCHADER - profesor në SHLP në Cyrih. Statutet ISEAL-it janë pranuar nga autoritetet federalet më 25 mars 2008, duke e njojur kështu ISEAL-in : Institut me Vlerë Publike.

albsuisse: Cili është qëllimi?

Driton Kajtazi: ISEAL-i ka për qëllim zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, të ndihmojë integrimin e shqiptarëve në Zvicër, të bëhet një partner i njojur prej autoriteteve të



Driton Kajtazi

Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe të shërbejë si pikë referimi përvende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjet shqiptare në përgjithësi.

Fondacioni ISEAL ndjek qëllime me vlerë publike, duke përashtuar çdo qëllim përfitimi.

albsuisse: Cila është përkrahja e Institutit nga Institucionet zvicërane dhe ato në hapësirën shqiptare?

Driton Kajtazi: Vetë njojja nga Konfederata Zvicërane e ISEAL-it si Institut me Vlerë Publike na përkrah dhe i hap të gjitha dyert për veprim konkret të mirëfilltë.

Për shembull, ne e kemi të njojur logon dhe mundësinë e botimit të librave të ndryshëm në gjuhën gjermane, frenge, italiane apo shqipe, pa pasur nevojë të kërkojmë botues, sikur gjë më tanë. Nga ky moment, e tëra varet nga ne, si do ta vëmë në veprim njojjen e Institutit me Vlerë Publike.

Në takimet e shumta që kemi pasur gjer

më tanë, të gjitha autoritetet në Zvicër e kanë vënë në pah atë se po fillon një proces i bashkëpunimit me ISEAL-in.

Kemi pasur kontakte të shumta edhe me autoritetet e institucione të ndryshme në Kosovë e më gjér.

albsuisse: A mund të na e zërberhen strukturën e Institutit?

Driton Kajtazi: Këshilli i Fondacionit ISEAL, i përbërë nga 11 themeluesit e saj, e emëron Drejtorinë e ISEAL-it.

Këshilli i Fondacionit ISEAL është organi përgjegjës i cili i përcakton drejtimet e ISEAL-it.

Drejtoria dhe bashkëpunëtorët e ISEAL-it kujdesen në vazhdimësi përmbarëvajtjen dhe realizimin e këtyre drejtimeve. Shpresojmë të krijojmë mundësitë e nevojshme buxhetore në mënyrë që të angazhojmë bashkëpunëtore e bashkëpunëtore profesional shqiptarë dhe zvicëranc, etj.

Sa i përket strukturave, për t'i arritur qëllimet e tij, ISEAL-i do të shfrytëzojë një Institut Shkencor me 4 sektorët e mëposhtëm:

- Kërkime: Të bëjë kërkime në fusha të ndryshme, si: formimi, integrimi, politika, gjuhësia, sociologjia, ekonomia, kultura, historja, gjeografia dhe teologjia.

- Botime: Të batojë vepra periodike, libra, broshura dhe butetinë të tjera (në gjermanisht, frëngjisht, italisht, shqip etj.).

- Mësimdhënie: Të japë një mësimdhënie e cila do të përfundojë me formime të vërtetuara dhe/ose me kredi ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System).

- Qendër dokumentimi: Në bashkëpunim me universitetet, shkollat e larta, bibliotekat dhe autoritetet e Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë si dhe me institutet të ndryshme private apo publike.

albsuisse: Cilat janë planet e Institutit?

Driton Kajtazi: Në plane afatshkurta e

kemi një simpozium shkencor, "INTEGRIMI I SHQIPTARËVE NË ZVICËR", me një qasje të kryqëzuar me komunitetë të tjera (në bashkë-organizim me Universitetin e Lozanës, më 13 nëntor 2010 në lokalet e IDHEAP-it - Instituti i studimeve të larta në Administratë Publike).

Po ashtu, nga fillimi i muajit qershor 2010, do të vëmë në veprim Web Faqen e ISEAL-it (www.iseal.ch) Kjo faqe e Internet-it është në fazën finale dhe fillimisht do të jetë në gjuhën gjermane, frange dhe shqipe e më vonë e kemi në plan ta zgjerojmë edhe në gjuhën angleze dhe italiane.

Në vjeshtën 2010, do të hapim edhe lokalet e ISEAL-it si dhe do ta organizojmë një mbrëmje solemne në muajin nëntor 2010. Këto janë disa nga planet afatsh-kurtëra.

albsuisse: A mund të na përmendi edhe ca plane afatgjata ?

Driton Kajtazi: Në plane afatgjata më lejoni të përmend disa projekte:

- SHQIPTARET E ZVICRËS, një kërkim i thellë ekipo, i shoqëruar me një botim të

- ARTI made in Kosov@..., ekspozita në Zvicër të artistëve dhe të artit kosovar.

- NJË EKONOMI APO VETËM KURSIME?, forum ekonomik.

- NJË E ARDHME FEMËRORE, studim përfemrën shqiptare në Zvicër.

- SI JENI ME SHËNDET?*, kërkim mbi shëndetin publik *Comment va votre santé?

- FJALA PAMJEVE - LA PAROLE AUX IMAGES, paraqitje e kinematografisë në gjuhën shqipe.

Të gjitha këto projekte, do të mund të realizohen vetëm me krijimin e mundësive materiale dhe mundësinë e angazhimit të personave profesional.

albsuisse: Cili do të jetë bashkëpunimi i Institutit ISEAL me shoqatat shqiptare në Zvicër ?

Driton Kajtazi: Ne që tani e kemi një bashkëpunim shumë të mirë. Mjafton të shikohet lista e personalitetave që drejtojnë shoqata nga më të ndryshmet në Zvicër dhe që kanë vendosur ta përkrahin ISEAL-in duke u bërë pjesë e Shoqatës

meve tona të ndërsjella.

albsuisse: Ju e keni themeluar edhe Shoqatën e Miqëve të ISEAL-it. Cili është roli i kësaj shoqate ?

Driton Kajtazi: Themelimi i shoqatave të tilla, në mbështetje të institucioneve të ndryshme, praktikohet me të madhe në Zvicër dhe gjetiu. Ajo që na bën të besojmë se ISEAL-i nuk mbetet vetëm nismë është ajo se para fillimit të aktivitetave, është krijuar Shoqata e Miqve të ISEAL-it: aA0ISEAL. Kjo shoqatë është krijuar nga mbi 132 personalitetë shqiptare, zvicerane dhe të tjerë. Nga muaji qershor 2010, të gjithë personat që dëshirojnë të përkrahin ISEAL-in dhe të bëhen anëtarë në këtë Shoqatë janë të mirëseardhur. Në faqen tonë të Internet-it, do t'i kenë të gjitha të dhënat e nevojshme (statute, etj). Shoqata drejtobhet aktualisht nga Komiti i përbërë nga Z. Visar QUSAJ - kryetar, Z. Arsim FERIZI - anëtar, Z. Jean RUFENER - anëtar, Znj. Lucy CLAVEL RAEMY - anëtare, Z. Mentor ILAZI - anëtar.

Shoqata aA0ISEAL e ka edhe një Komitet nderi me 12 anëtarë: Prof. Dr. Antonio DA CUNHA, Prof. Astrit LEKA, Znj. Barbara HAERING, Dr. Christian ZINDEL, Z. Georges CUENOT, Znj. Katherina WASHINGTON, Shkël. e tij, Z. Mehmet ELEZI, Z. Rolf ALTHERR, Z. Ueli LEUENBERGER, Z. Xhemali BERISHA, dhe e madhja Znj. Vaçe ZELA.

albsuisse:Cila është porosia e juaj për shqiptarët në Zvicër?

Driton Kajtazi: Të jemi krenar e mirënjohës me punën e prindërvë tanë mërgimtarë, me këtë gjeneratë të sakrifikuar, duke mos e anashkaluar punën tyre të bërë në kushte të një kohe të pakohë.

Ne u japim jetë ëndërrave të tyre, vetëm me punë konkrete. Këtu do të citoja se Nëse ëndërrojmë vetëm, kjo mbetet vetëm një ëndërr, nëse ëndërrojmë bashkërisht ky është fillimi i një realiteti. ISEAL-i është dhe do të jetë në shërbim të të gjithëve. Ne do të punojmë fryshtë, shprehjes: "Për të ecur shpejtë, ec vetëm, për të shkuar më larg, ec së bashku me të tjerët".

Juve ju uroj punë të mbarë, duke ju falënderuar për kujdes dhe i përshëndes lexuesit tuaj.

Faleminderit për bisedën, albsuisse ju uron suksese në punën tuaj te mëtuteshme

Bashkëbisedoi: Bedri Krasniqi



-ISEAL Berne prill 2010

ilustruar, të botuar në gjuhën gjermane, frange, italiane dhe shqipe.

- ANTOLOGJI E LETËRSISË SHQIPTARE, botim në gjuhën gjermane, frange dhe italiane (vështrim historik, paraqitje e autorëve, tekste të zgjedhura, dokumente dhe komente).

- ANTOLOGJI E LETËRSISË ZVICERANE, botim në gjuhën shqipe (vështrim historik, paraqitje e autorëve, tekste të zgjedhura, dokumente dhe komente).

së Miqve të ISEAL-it: aA0ISEAL (në Web Faqen e ISEAL-it qershor 2010).

Kuptohet, ne nuk e kemi as qëllim e as synim që të punojmë "in vitro", të shkëputur nga realiteti, por synimi themelor i ISEAL-it është që të zhvillojmë projekte të kërkimeve aplikative, projekte "in vivo". Qëllimi ynë është që të vëmë në aplikim konkret projektet tona, në bashkërenditje me shoqata të cilat e njohin terrenin konkretisht, të cilat i japin jetë bashkëveprirës.